

**AKTNORMATIV**  
**Nr.3, datë 2.12.1999**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8516, DATË 22.7.1999 "PËR DISA NDRYSHIME  
NË LIGJIN NR.8439, DATË 29.12.1998 "PËR BUXHETIN E SHTETIT PËR VITIN  
1999""**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Në ligjin nr.8516, datë 22.7.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8439, datë 29.12.1998 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 1999", fondi i dhënë në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në zërin "Investime", të përdoret si subvencion për blerjen e energjisë elektrike.

2. Ministrisë së Financave i pakësohen 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë në zërin "Kosto e ristrukturimit të bankave". Ky fond prej 500 000 000 lekësh i shtohet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në zërin "Subvencion" për blerjen e energjisë elektrike nga shoqëria anonime "Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare".

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij aktinormativ.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**